


Besimtari

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti III i botimit, Nëntor 2009 Nr. 31. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj

DUKURI HYJNORE DHE MADHESHTORE E ALLAHUT TE LARTESUAR

Mediat e shkruara dhe vizive kanë dhënë një lajm të pandëgjuar ndonjëherë, cili i bën jehonë një dukurie që ata e quajnë një mrekulli. Fjala është për një ngjarje të pazakontë që ka ndodhur ne Dagestanin e largët musliman, ku ka lindur një fëmijë. Deri këtu nuk ka ndonjë gjë të vecantë për t'u vënë në dukje. Por, e vecanta filloi pas një jave kur, ne mjekrën e fëmijës të sapolindur u shfaq fjala Allah e cila u pasua nga ajete kuranore të cilat filluan të shfaqen në trupin e tij, ajete këto të shkruara në gjuhën arabe. Nena e fëmijës, i cili tashti është 9 muajsh dhe quhet Ali Jakupi, tregon se ajetet shfaqen në trupin e Aliut të vogël ditën e hënë dhe ditën e xhuma, kur edhe mund të lexohen shumë lehtë. Në momentin, kur fillojnë të duken shkronjat e ajeteve kuranore, Aliu fillon të qajë, nuk ka qetësi dhe fillon t'i ngrihet temperatura e cila nuk zbret edhe kur atij i jepen ilace për t'ia ulur atë. Medina, nëna e Aliut thotë se është shumë e dhimshme, kur e shikon Aliun duke vuajtur dhe nuk mund ta ndihmosh deri sa ai qetësohet vetvetiu, pasi trupi i tij është mbushur me ajete kuranore të cilat vazhdojnë të dalin duke u zavendësuar nga ajete të tjera. Ne nuk jemi në gjendje që ta mbajmë në duar, kur ai është në atë gjendje të rëndë dhe detyrohemi që ta lidhim në djepm për aq kohë sa vazhdon shfaqja e ajeteve kuranore në trupin e tij- thotë Medina nëna e Aliut. Ministri i pushtetit lokal në Dagestan thotë se kjo dukuri është një shenjë e pastër e dërguar nga Allahu. Kurse imami i xhamisë së atij lokaliteti, ku ka lindur Aliu, thotë se në parashikimet e Kuranit të Madhërueshëm për fundin e botës shkruhet se do të jetë një moment kohor, kur njerëzit do të kenë thëniet kuranore të shkruara në trupin e tyre. Allahu urdhëron që këto shenja mos të fshihen nga njerëzit e vazhdon bisedën e tij, imam, Abdullahu. Shumë domethënëse është edhe dalja e një ajeti kuranor në këmbën e djathtë



të Aliut të vogël një herë në javë, ku shkruhet qartë me shkronja arabe "Ji mirënjohës ndaj Allahut" Kjo dukuri hyjnore ka tërhequr vëmendjen e mediave ruse dhe të huaja pa harruar edhe angazhimin e internetit për të bërë sa më publik një dukuri të tillë hyjnore. Tashmë shtëpia e kësaj familjeje muslimane, ku është shfaqur kjo dukuri hyjnore, është bërë një vend që vizitohet nga mijra besimtarë në ditë të cilët janë muslimanë dhe jo muslimanë. Ata duan të behen dëshmitarë të kësaj mrekulie hyjnore duke qenë vetë dëshmitarë okularë të saj. Mesazhi hyjnor, që Allahu xh.sh. dërgoi përmes këtij fëmije 9 muajsh, nuk është një meazh vetëm për muslimanët, por është një mesazh për të gjithë njerëzimin, për të gjitha fetë të cilat përcjellin mesazhet e tyre në emër të Zotit, duke u kujtuar njerëzve se ata duhet të jenë mirënjohës ndaj Zotit të tyre i cili u kujton vazhdimisht se ai egziston dhe kjo egzistencë është e padiskutueshme edhe për skeptikët më fanatikë. Meazhe për egzistencën e tij,

Allahu i Madhërueshëm ka dërguar vazhdimisht për njerëzimin, për t'u kujtuar atyre se ata janë vetëm rob të Allahut xh.sh. dhe se duhet t'u binden urdherave të tij. Gjithashtu mesazhet hyjnore të Allahut xh.sh. u kanë kujtuar njerëzve që të pendohen deri sa nuk është vonë për gjynahet që kanë bërë dhe të kthehen në rrugën e drejtë të Allahut xh.sh. Mosbesimtarët, ateistët dhe njerëz të tjerë të maskuar që flasin në emër të fesë dhe realisht punojnë në kundërshtim me ligjet e Allahut xh.sh., duhet të kenë frikë nga Allahu i Madhërueshëm dhe të heqin dorë nga dyfytërsia, e cila do t'i dërgojë ata në zjarrin e xhenemit, ku vuajtja e tyre nuk do të ketë limit në kohë. Mesazhi që i erdhi njerëzimit nga Dagestanin e largët musliman tregon se njerëzimi po ecën në një rrugë të devijuar nga rruga e Allahut xh.sh. dhe po zhytet në vese të shfrenuara të cilat po marrin të drejtën e qytetarisë dhe po e cojnë shoqërinë njerëzore drejt një shkatërrimi të sigurtë, veprime këto që tregojnë se njerëzit

e kanë harruar frikën nga Krijuesi i Gjithësisë, e kanë harruar llogaridhënien para Krijuesit të Gjithësisë dhe po shijojnë të mirat e kësaj bote, duke u zhytur në një jetë ku harami është baza e saj. Por, Allahu i Madhërueshëm është mëshirues dhe e don krijesën e tij më të përsosur që është njeriu. Me mesazhe të vazhdueshme, Allahu xh.sh. i kujton dhe i tërheq verejtjen atij që të jetë mirënjohës ndaj Allahut xh.sh. dhe t'i luten vtëm atij dhe të adhurojë vetëm ATE, sepse vetëm kështu njerëzit do të jenë të shpetuar në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Prandaj, o njerëz! Pendohuni dhe kthehuni në rrugën e Allahut xh.sh. deri sa nuk është vonë! Allahu është i mëshirshëm dhe falës i madh. Kjo është edhe arsyeja përse Ai i dërgoi mesazhin hyjnor në Dagestanin e largët musliman njerëzimit që njerëzimi të besojë në egzistencën e Allahut xh. sh. dhe të bëhet rob i Allahut xh.sh., adhures i Tij dhe ndjekës i rrugës së Allahut xh.sh. deri në ditë gjykimit.

Selim Gokaj

INFORMACIONE NGA "ZERI I TURQISE"

TURQIA MBRON REPUBLIKEN ISLAMIKE TE IRANIT

Në pragun e vizitës së kryeministrit të Turqisë, Taip Rexhep Erdogan, në Republikën Islamike të Iranit, mediat ndërkombëtare kanë publikuar një deklaratë të kryeministrit turk, Erdogan, i cili ka denoncuar qëndrimin që po mbajnë ndaj Republikës Islamike të Iranit disa shtete që domonojnë politikën botërore të cilat, pa përjashtim, secili prej tyre ka armë bërthamore dhe potencial të gjithanshëm bërthamor. Në deklaratën e tij, Erdogan, tha se presidenti i Republikës së Iranit, Ahmadinnexhad, është një mik

i Turqisë. Kjo deklaratë e kryeministrit të Turqisë tregon se tashmë Turqia po distancohet nga qëndrimet që po mbahen ndaj Iranit nga fuqite bërthamore më të medha të planetit të cilat na kujtojnë se ata po bejne të njëjtat akuza ndaj Iranit si ata që u bënë edhe kundër Irakut në pragun e sulmit ushtarak kundër tij, akuza për të cilat më vonë u kërkua falje po nga ata që i kishin thurur pa të drejtë këto akuza. Por, falja që u kërkua nuk kishte më vlerë, sepse tashmë Irakut i kishte dalë flaka në maje dhe sot

viktimat e kësaj lufte kapin shifrat e qindra mijrave, pa llogaritur dëmin kolosal ekonomik me të cilin sot përballohet Iraku. Qëndrimi realist ndaj Iranit, që po mban sot Turqia dhe demaskimi publik i akuzave të pa baza që po i bën faktori ndërkombëtar Iranit, është një ndihmese për te parandaluar konfliktet e rrezikshme që sot kercenojnë hapësirat në Lindjen e Mesme, ku interesat e fuqive të medha perendimore kerkohen t'u imponohen me force vendeve të rajonit.

KRYEMINISTRI ERDOGAN KUNDER ARMEVE BERTHAMORE

Në një intervistë të cilën kryeministri i Turqisë, Taip Rexhep Erdogan i dha një stacioni televiziv shumë të njohur amerikan, nuk e anashkaloj problemin e Iranit të cilin bota perëndimore po e penalizon si shtet që përpiket të prodhojë armë bërthamore, duke pasuruar uraniumin si lëndë e parë që nevojitet për të realizuar prodhimin e armëve bërthamore. Kryeministri Erdogan theksoi se Turqia është për një rajon pa armë bërthamore të cilat nuk duhet t'i zhvillojë as t'i ketë Irani dhe as Izraeli, duke treguar kështu publikisht se rajoni i Lindjes së Mesme

nuk është i kërcënuar vetëm nga Irani i cili faktikisht vetëm sa dyshohet se ka plane për të prodhuar armë bërthamore, por ky rajon kërcënohet edhe nga shteti Izraelit i cili sot i ka faktikisht armët bërthamore dhe përpiket që ato t'i ketë monopol vetëm ai. Duke folur për mardheniet e Turqisë me Iranin, kryeministri, Erdogan, theksoi se këto marrëdhënie janë shumë të vjetra dhe shumë të qëndrueshme, duke treguar kështu se Turqia nuk do të shkojë pas qerres së shteteve që ngrejne akuza për të krijuar vatra të reja lufte, ku viktima janë popujt e pa-

fajshem muslimanë. Atmosfera politike që po krijohet rreth Iranit të krijon përshtypjen se është e njëjta atmosferë që u krijua para sulmit që u ndërmor kundër Irakut i cili solli pushtimin e tij që u shoqërua me një shkatërrim të paimagjueshem materjal dhe shpirtëror, i shoqëruar edhe me një gjakderdhje që vazhdon edhe sot. Urojmë që Irani të mos e pësojë fatin e Irakut, megjithëse Irani nuk është Iraku te cilit i doli shpejt tymi në maje.

KRYEMINISTRI I TURQISE VIZITON IRANIN

Kryeministri i Turqisë, Taip Rexhep Erdogan, ka bërë një vizitë në Republikën Islamike të Iranit ku është takuar me zyrtarët më të lartë të këtij shteti islamik. Ka qenë një vizitë disa ditore e realizuar në një situatë tensioni diplomatik në mes të Iranit dhe të shteteve perëndimore të cilët përpiqen të ndalin aktivitetin bërthamor të Iranit duke e akuzuar atë për plane që synojnë ta paisin Republikën Islamike të Iranit me armë bërthamore, në një kohë që Irani deklaroi se ka si qëllim përdorimin e energjisë bërthamore për qëllime paqësore duke nënkuptuar se ekonomia e tij duhet të ketë edhe energji bërthamore që ta cojë Iranin përpara. Vizita e kryeministrit turk në këtë situatë në Iranin tregon se Turqia është tashmë një shtet që në rajon ka rol të rëndësishëm i cili nuk është i monitoruar nga asnjë qendër ndërkombëtare, por është

një lëvizje e pavarur politike që i shërben si Turqisë, ashtu edhe Iranit. Mediat ndërkombëtare, turke dhe iraniane bëjnë të ditur se kryeministri Erdogan ka takuar edhe presidentin Ahmadinnexhad me të cilin ka biseduar për probleme që kanë të bëjnë me marrëdhëniet në mes të dy shteteve. Gjithashtu ata kanë biseduar edhe për rajonin dhe për probleme ekonomike të cilat janë shoqëruar me nënshkrimin e shume kontratave, sidomos për ata energjetike të cilat lidhen me naftën dhe gazin iranian dhe rrugët me të cilat ata do të transportohen në rajon dhe më gjërë. Në një intervistë që u dha gazetarëve pas takimit me zyrtarët e lartë iranianë, kryeministri i Turqisë theksoi të drejtën e pakontestueshme që ka Irani për të përdorur energjinë bërthamore për qëllime paqësore, të drejtë që e ka edhe Turqia, sepse

kjo është e drejtë e secilit shtet të botës. Duke folur për nivelin e marrëdhënjeve të Turqisë me Izraelin, Erdogan theksoi se këto marrëdhënie janë në kufirin e marrëdhënjeve të drejtësisë dhe mbrenda hapësirës së politikës së Turqisë. Akush nuk mund t'i imponojë Turqisë një politikë e cila do ta bënte atë të varur nga të tjerët - deklaroi kryeministri turk. Vizita e kryeministrit të Turqisë në Iran tregon se bota duhet të njohë edhe anën tjetër të medaljes e cila është portreti i vërtetë i Republikës Islamike të Iranit, portret ky larg penalizimeve dhe larg paragjykitimeve të Perëndimit që është i interesuar të frenojë zhvillimin dhe përparimin e Iranit, sepse duket që Irani është e vetmja pengesë për realizimin e planeve të Perëndimit në rajon dhe më gjërë,

NENE TEREZA NUK DO TE KTHEHET NE SHQIPERI

Në kuadrin e kthimit të eshtrave të figurave të rëndësishme të kombit shqiptar në Shqipëri ,qeveria e kryeministrit Berisha ka kërkuar nga qeveria indiane që të lejojë kthimin e eshtrave të Nënë Terezës në Shqipëri, pasi ajo është varrosur në shtetin e Indisë. Pergjigja ishte e pritshme .Qeveria indiane e refuzoi kërkesën me motivin se Tereze Bojaxhi ishte nënshtetëse indiane dhe se aktivitetin e saj bamirës e kishte bërë në Kalkuta, aq sa ajo njihet edhe si "Nënë Tereza e Kalkutës".Nga ana tjetër edhe herarkia e lartë e kishës katolike shqiptare e kundërshtoi publikisht iniciativën e qeverisë shqiptare për të sjellë eshtrat e Tereze Bojaxhiut në Shqipëri. Perpjekja e politikës shqiptare dhe e segmenteve të tjerë jashtë kësaj politike për ta përdorur këtë figurë fetare për interesa të caktuara politike-fetare, kësaj rralle mori një goditje publike ndërkombëtare, duke treguar se nuk mjafton vetëm origjina dhe lidhja e gjakut për të lartësuar dhe për të përvetësuar një figurë të përmasave të kësaj zonje të nderuar, por duhet vlerësuar aktiviteti i saj dhe duhen njohur ata që e sponsorizuan këtë aktivitet dhe ata që e shpërblyen Tereze Bojaxhiun për këtë aktivitet me shenjtërimin e saj.Askush nuk duhet ta penalizojë këtë zonjë të nderuar, sepse humanizmi dhe bamirësia janë akte që i nderon mbarë njerëzimi.Por, kur problemi shtrohet tek përdorimi i kësaj zonje të nderuar për qëllime politike- fetare, atëherë analiza merr një karakter tjetër.Përpyekjet për t'i dhënë ngjyrën e një miti kësaj zonje të nderuar, të cilën askush nuk duhet ta kontestojë, është pjesë e një politike

që ka si qëllim imponimin e një figureje fetare si figurë kombëtare për të gjithë shqiptarët, veprim që tentohet të realizohet duke vënë në lëvizje mediat, politikën shtetërore dhe linja të pafundme që janë fokusuar të na bindin se Tereze Bojaxhi është nëna e tërë botës dhe se shqiptarët, si pjesë e kësaj bote, duhet ta pranojnë si nënë. të tyren Por, as mizëria e busteve të kesaj zonje të nderuar në hapësirat shqiptare, as stuhia e propogandës mediatike, as botimet e panumurta , as cmimi Nobel nuk kanë qenë të mjaftueshme për të bindur njerëzit se Nënë Tereza është një figurë kombëtare shqiptare. Arsyeja tashmë është e thjeshtë. Ajo realisht është një murgeshë katolike, një misionare e krishterë e cila, me aktivitetin e saj human dhe bamirës, i ka shërbyer pikërisht rritjes së reputacionit të fesë së krishterë. Prandaj, edhe është nderuar , vlerësuar dhe shenjtëruar nga Vatikani i cili, pa tjetër që nuk ka qenë dakort që eshtrat e kësaj shenjtoreje katolike të udhëtojnë drejt Shqipërisë, mesazh ky ,si e theksuam më lart, iu bë me dije qeverisë shqiptare nga kisha katolike shqiptare.Qeveria shqiptare ka shkuar aq larg në mitizimin pa të drejtë të kësaj figureje fetare, sa ka shpallur ditën e shenjtërimit të kësaj murgeshje katolike si festë zyrtare për të gjithë shqiptarët, në një kohë që shteti në Shqipëri është saktësisht laik dhe laicizmi i shtetit nuk duhet nëpërkëmbur.Nuk duhet të harrojmë përpjekjen për të vendosur figurën e Tereze Bojaxhiut në karten e identitetit të shqiptarëve, duke kërkuar të tjetërsohet identiteti i muslimanëve që përbëjnë shumicën e popullsisë në Shqipëri.Duket se "Dikush" mendoj qe u bë deti kos dhe o burra t'ua vendosim të

gjithë shqiptarëve në xhep Tereze Bojaxhiun. Ishte një reflektim i drejtë i qeverisë shqiptare, pas presionit të shoqatave muslimane dhe të institucioneve muslimane, që e anuloi procesin e vendosjes së kësaj shenjtoreje katolike në kartën e identitetit.Kontributi i saj për shqiptarët dhe Shqipërinë nuk ka asnjë parametër që mund të merret në konsideratë. Kjo është dhe arsyeja perse shteti shqiptar nuk i ka akorduar Tereze Bojaxhiut asnjë dekoratë apo titull nderi, sepse shteti nuk ka motiv për të dhënë vlerësime të tilla. Prandaj,përpyekjet për mitizim e kësaj figureje fetare dhe kthimin e saj ne një figurë kombëtare, janë jashtë të së vërtetës, sepse për një gjë të tillë mungojnë argumentet që do të motivonin një veprim të tillë.Kjo është edhe arsyeja që është mirë ta lëmë Tereze Bojaxhiun në qetësinë e saj , me cmimin Nobel që i është dhënë dhe me shenjtërimin që i ka bërë qendra e religjonit të saj dhe mos ta lakojmë në biseda dhe debate televizive, ku ligjërojnë tipa si Kadareja, të njohur tashmë për qëndrime të dyshimta politike dhe fetare, sepse atëhere do të bëhet pyetja e rëndë"Mos stuhija mediatike dhe shtetërore që është ngritur për të imponuar një murgeshë katolike si figurë kombëtare për të gjithë shqiptarët është pjesë e përpjekjeve për një rikonkuistë të muslimanëve shqiptarë në hapësirat ku ato jetojnë, të cilëve Evropa raciste dhe e krishterë nuk po u jep as viza për të lëvizur në hapësirat e saj si fqinjëve të saj ortodoksë?

SelimGokaj

QEVERIA SHQIPETARE NDERON MBRETIN AHMET ZOGU

Kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ka bërë publike një nismë të qeverisë shqiptare për të sjellë në Atdhe eshtrat e Mbretit Ahmet Zogu të cilat aktualisht sot janë në Francë ku ku mreti Zog nderoi jetë larg Atdheut të vet.Ky veprim i qeverisë shqiptare është një veprim që duhet përshëndetur nga të gjithë shqiptarët, sepse me figurën e Ahmet Zogut është e lidhur një pjesë e rëndësishme e politikës dhe e historisë së Shqipërisë e cila mbart dhe prezenton vlerat e këtij personaliteti politik largpamës dhe shumë të aftë për të vënë themelet e një shteti modern dhe njekohësisht për të mbrojtur interesat e këtij shteti. Eshte e drejtë që të kujtojmë se sistemi komunist kishte ngritur një stuhi të egër diskriminuese kundër mbretit Ahmet Zogu, duke e akuzuar për veprime të paqena që e tregonin figurën e tij mbrenda kornizave të një politikani që e kishte shitur atdheun e tij tek të huajt dhe në vitin 1939 nuk

u dha armë shqiptarëve që të luftonin kundër Italisë fashiste që pushtoi Shqipërinë, por ,pasi e sabotoi rezistencën e një populli që kërkonte armë për të luftuar, e braktisi Atdheun e vet në vend që të vihej në ballë të popullit për ta mbrojtur Shqipërinë. Këto akuza patën krijuar në shumë shtresa të popullit shqiptar ,sidomos të atyre që nuk e patën jetuar atë periudhë historike, një imazh ku urrejtja për Mbretin Ahmet Zogu kishte kapur parametra shumë të lartë. Portreti i tij, i bazuar në të pavërteta, kompletohej nga diktatura edhe me idenë se ai u kishte rrëmbyer arin shqiptarëve atë ditë që e braktisi Shqipërinë , perrallë kjo që u muar si e vërtetë për dekada të tëra nga shqiptarët.Rënia e diktaturës komuniste bëri që të marrë fund portreti i rremë që i ishte bërë mbretit Ahmet Zogu. E vërteta që iu servir tashmë shqiptarëve ishte e bazuar në fakte dhe dokumenta të vërteta historike të cilat e vleresonin këtë figurë politike si model të një politikani që kishte punuar dhe

ishite përpjekur gjithë jetën e tij për të zhvilluar dhe për të lartësuar Atdheun e vet.Vendimi i qeverisë Berisha 2 për të sjellë eshtrat e mbretit të shqiptarëve në Atdheun e tij zgjoi nga gjumi disa politikanë të rinj, por me mentalitete të ballarëve të tyre komunistë si: Pandeli Majko që deklaroi në sheshin "Skenderbeu"se Ahmet Zogu është një figurë e dyshimtë .Kështu është dhe do të jetë gjithmonë figura e Mbretit të shqiptarëve në mendjen e atyre që janë dhe vazhdojnë të jenë pjesë e persekutimit të mbretit të shqiptarëve, por që sot, për fat të mirë, ata janë vetën një zë i vetmuar në shkretirë, duke u ngjasuar korbave te zinj që me pamjen dhe zërin e tyre të bezdisshën krijojnë vetëm shqetësim në hapësirat ku ata vërtiten.

Alban Kastrati

SHAMIA MUSLIMANE SULMOHET POLITIKISHT



Sapo Perëndimi e fitoi betejën e rëndë me komunizmin, të cilin vetë e pat projektuar dhe po vetë e pat hedhur në terren për zbatim, ai filloi një betejë tjetër të cilën e pat lënë në sirtar për ta nxerre prej tij, sapo ta shihnte vehten pa kundërshtar. Kundërshtari me të cilin filloi të konfrontohej Perëndimi ishte Islami, një religjon të cilit Perëndimi i pat shpallur luftë shekuj më parë, kur me zjarr dhe hekur kolonizonte dhe u vinte sllavërinë në zverk vendeve muslimane. Prandaj, beteja kundër islamit për Perëndimin nuk është e re, por kuptohet se tashti ajo ka marrë përmasat e një betejave ku janë vënë në lëvizje forca, dhuna, media, fitneja dhe tradhëtia, të cilat fokusohen

tek pengimi dhe ndalimi i mesazhit islam. Pjesë e kësaj beteje është edhe penalizimi i shamisë muslimane, si dukuri, që, sipas Perëndimit, cënon karakterin laik të hapësirës ku ajo është prezente. Bota është dëshmitare e qëndrimit racist kundër shamisë muslimane të shumë vendeve evropiane, ku startojnë ashpër Franca, Holanda, Belgjika dhe shtete të tjera jo më pak paragjyquese për shaminë muslimane. Të mos harrojmë se ky penalizim kundër shamisë muslimane po bëhet në një kohë, kur shoqëria perëndimore po kap majat e degjenerimit dhe të shturjes morale. Martesat mbrenda të njëjtës gjini po ligjërohen me ligj në ato shtete që na serviren për model morali dhe demokracie. Ky degjenerim i shoqërisë perëndimore po rëndohet edhe më shumë nga një lakuriqësi e cila na kujton primitivitetin, ku njeriu me veshjen e tij shumë pak dallohet nga kafsha. Janë po këto ideologji, po këto qendra, po këto shtete që i hedhin në treg këto modele imoraliteti të cilët i janë sulur shamisë muslimane, duke e etiketuar atë si regres, si dukuri fanatike, si fenomen me të cilën dhunohet femra, si një dukuri që i imponohet femrës muslimane nga ambjenti ku ajo jeton. I gjithë ky penalizim, që është vetëm një mashtrim, ka për qëllim që ta nxerrë shaminë muslimane jashtë detyrimit fetar që ka vënia e saj, detyrim që është obligim për secilen femër muslimane. Një penalizim i tillë kundër shamisë muslimane për fat të keq është shtrirë në gjitha hapësirat, ku jetojnë muslimanët, përfshirë edhe ato ku jetojnë muslimanët shqiptarë. Mediat kanë bërë publike raste të panumarta, ku janë përjashtuar nga shkolla vajza me shami, djem me mjekra, mësuese me shami dhe punonjëse të administratës me shami,

si në Shqipërinë londineze, ashtu edhe në Kosovë e Maqedoni. Ka shumë arsye të sajara për të penalizuar shaminë muslimane, duke filuar nga cënimi i karakterit laik të shkollës dhe duke përfunduar tek një model që ambjenti e përjashton. Por, e verteta që penalizohet dhe sulmohet shamia muslimane është jo vetëm paraqitja e femrës muslimane me shami, sepse shamia është fakt që e ndrit paraqitjen e femrës, por familja muslimane, në ambjentet e së cilës jeton një femër e mbuluar, e cila është argument për egzistencën e një familjeje praktikante muslimane, ku degjenerimi nuk mund të bëhet banor i saj, ku lakuriqësia është e përjashtuar, ku nëpërkëmbja e prindërve nuk është pjesë e saj, ku demokracia dhe liria pa limit nuk mund të gjeje hapësirë. Pikërisht për këto tregues dhe tregues të tjerë të kësaj linje, sot penalizohet shamia muslimane e cila, për moralin antinjerëzor dhe shkatërrues të shoqërisë së sotme, është pengesë e pakapërcyeshme. Prandaj, i shikuar pak më thjesht problemi, beteja kundër shamisë muslimane është betejë kundër moralit islam i cili nuk ka asgjë të përbashkët me moralin bashkohor perëndimor, që, i fshehur pas sllaganit se njeriu duhet të ketë të drejta dhe të jetë i lirë, ka krijuar modelin e njeriut me moral të dyshimtë dhe të shturur, duke kërcënuar kështu edhe vetë vazhdimësinë e shoqërisë njerëzore. Prandaj, beteja kundër shamisë muslimane dhe penalizimi i saj mediatic, administrativ dhe politik është betejë në mes të moralit islam dhe imoralitetit perëndimor. Nga ky kënd është mire të behet edhe debati për shaminë muslimane.

Bledar Dani

PRESIDENTI OBAMA PËR MBULESEN E GRUAS MUSLIMANE

Në vizitën që bëri në Egjipt, presidenti Obama u prononcua edhe për mbulesën e femrës muslimane. Pasi dha një shifër zyrtare, sipas së cilës në SHBA sot jetojnë 7 milionë muslimanë dhe se në territorin e SHBA sot janë të ndërtuara 1200 xhamia, presidenti Obama u ndal tek qëndrimi i demokracisë amerikane ndaj mbulesës së femrës muslimane. Obama theksoi se qeveria amerikane mbron me ligj të drejtën

e grave dhe vajzave muslimane në SHBA dhe se ajo është kundër atyre që ndërhyjnë dhe përpiqen që vajzat dhe gratë muslimane t'i privojnë nga kjo e drejte. Duke vazhduar prononcimin e tij për këtë problem, ai iu drejtua vendeve perëndimore duke u kujtuar atyre se duhet të heqin dorë nga pretendimet e tyre për t'i detyruar muslimanët që të zbatojnë fenë e tyre ashtu si u intereson këtyre vendeve dhe ato duhet të heqin dorë edhe nga pretendimi për t'i detyruar gratë muslimane që të

veshën si u shkon për shtat këtyre vendeve. Një deklaram i tillë i qartë dhe i hapur nuk është bërë as nga drejtues të shumë vendeve muslimane, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, ku institucionet muslimane nuk arritën të ndalin qëndrimin e ministrit të arsimit shqiptar i cili u bë pjesë e atyre drejtuesve të shkollave që morën masa të ashpra ndaj disa vajzave të mbuluara të cilat kërkonin të vazhdonin shkollën dhe të mos u hiqej shamia. U mbetet tashmë vendeve perëndimore që të rishikojnë qëndrimin e tyre ndaj muslimanëve

dhe mbulesës së grave muslimane duke pasë si pikë referimi qëndrimin e drejtë dhe larg diskriminimit që sot po mbajnë SHBA ndaj shamisë muslimane në territorin e SHBA. Po kështu edhe shteti shqiptar ka shumë nevojë për parametrat me të cilët sot trajtohen muslimanët në demokracinë amerikane dhe të mos përpiqet të marrë flamurin kundër shumë problemeve që kanë të bëjnë me muslimanët, duke u përpjekur të tregohet "Më katolik se Papa"

KESHILLA PER NJE JETE TE LUMTUR

Feja dhe imani i largojne të gjitha shqetësimet dhe brengat. Ato janë gjeja më e dashur për besimtarin.

Të përmendurit e Allahut sjell qetësim për zemrën dhe shlyen gjynahet, largon vuajtjet dhe sjell kënaqësinë e Allahut.

Pastroje zemrën tende nga urrejtja dhe lakmia dhe largo prej zemres tende mendimet e liga dhe te papëlqyera.

Libri është miku më i mirë. Prandaj, mbaje gjithmonë pranë dhe përpiqu të bësh vetëm mirë.

Mos harro se Allahu fal shumë dhe se Ai pranon pendime. Ai i fal robërit e vet dhe për vepra të mira ua shlyen mëkatet.

Jeto me Kur-anin. Lexoje dhe mësoje përmendësh, sepse Ai është ilaci më i mirë kundër brengave dhe pikëllimeve.

Kërko ndihmën e Allahut dhe besoja Atij të gjitha problemet tuaja. Duhet të jesh i kënaqur me përcaktimin e tij dhe le të jetë për ty Ai streha e fundit, sepse Ai të mjafton për gjithshka.

Fale ate që të ka krijuar padrejtësi dhe pajtohu me atë që është grindur me ty. Jepi atij që nuk të ka dhene dhe sillu mirë me atë që është sjellë keq me ty, sepse do të përjetosh gjithmonë siguri dhe gëzim.

Bëhu i kënaqur me pamjen tënde, zërin, pagën, familjen dhe me shtëpinë tënde dhe do të ndjesh një kënaqësi të vecantë dhe rehati të vërtetë.

Dije se pas cdo vuajtjeje vjen shpëtimi dhe pas errësirës vjen drita. Asnjë situatë nuk është e përhershme, sepse edhe vetë ditët janë të ndryshme.

Dije se dynjaja është shtëpi sprovash, përpjekjesh dhe vuajtjesh. Prandaj, pranoje jetën ashtu si është dhe kërko ndihmën e Allahut.

Një prej modeleve të lumturisë është duaaja e prindërve për ty. Prandaj sillu mirë me ata dhe kujdesu për jetën e tyre.

Përgaditur nga Bledar Dani

AMER HALID PER LIDHJET PARAMARTESORE

Me qenë se Allahu i Madh është Krijuesi i njeriut, Ai e di mirë si funksionon ky njeri dhe cilat janë nevojat e tij. Vetë Allahu xh. e ka paisë njeriun me ndjenjën e dashurisë e cila e ka një objektiv se ku do të investohet. Dhe ky objektiv është martesë e hershme, me qëllim që kjo dashuri të jetë pjesë e një investimi hallall. Por, besimtari duhet që të investojë dashurinë edhe për Allahun xh.sh., për të Derguarin e Tij, për Atdheun, për vëllazërinë muslimane dhe për shumë drejtime të tjera ku dashuria investohet vetëm në hapësirën e hallallit. Për fat të keq, sot një pjesë e madhe e dashurisë po shkon për lidhjet jashtëmartesore duke cënuar dashurinë që muslimani duhet të ketë për Zotin e tij, për profetin e tij, për familjen e tij, duke

u bërë kështu pjesë e atyre që imitojnë botën perëndimore, imitim ky që i ka marrë mendjen shumicës së të rinjve sot. Po shohim se po prodhohem me mijra këngë dhe videoklipe që i kushtohen vetëm dashurisë dhe lidhjeve jashtëmartesore. Jemi dëshmitarë të filmave, telenovelave që flasin për dashurinë e një djali me një vajzë, sikur në këtë botë nuk ka dashuri tjetër vecse asaj të lidhjeve jashtëmartesore. Pa dyshim, këto ide janë të importuara nga Perëndimi, sepse atje, kur vajza ose djali mbushi 18 vjet ata gëzojnë pavarësi të plotë nga familja e cila mund t'u sigurojë atyre edhe një shtëpi kumund të bashkëjetojnë me një partner. Ata nuk kanë ndonjë marëveshje por thjehtë kënaqin njëri tjetrin. Ata vazhdojnë kështu deri sa mërzhiten me njëri tjetrin dhe pastaj ndahen për të gjetur një partner tjetër. Vetëm një përqindje e vogël nga këto cifte



që bashkëjetojnë me vite të tëra kanë shansin që të marrohen dhe të krijojnë familje të rregullt. Gjatë bashkëjetesës atyre mund t'u lindin edhe fëmijë të cilët i mbesin nënës, kur babai i braktis atë. Këta nëna me këta fëmijë në Perëndim sot quhen nëna beqare. Sapo kjo nënë beqare ndahet nga partneri me të cilin ajo ka bashkëjetuar ajo përpiket të

të kërkojë një partner tjetër që të kujdeset për atë dhe për fëmijët saj. Është e faktuar se një përqindje e madhe e perëndimorve bëjnë një jetë të tillë. Prandaj ju motra dhe ju vëllezë muslimanë në se do të dëshëroni të imitoni Perëndimindhe nuk dëshëroni të ndëgjoni porositë e Zotit në Kur-an pa tjetër do të vuani sepse.

NE IZRAEL ARRESTOHET NJE TERRORIST HEBRE

Izraeli ka bërë të ditur se në territorin e tij është arrestuar një terrorist hebre, i akuzuar se ka vrarë dy palestizë të pafajshëm. Terroristi në fjalë ka qenë një hebre që ka jetuar në SHBA, por ka emigruar në Izrael më qëllim vrasjen e palestinezëve të pa-

fajshëm. Gjatë marrjes në pyetje, ai ka pranuar se ka vrarë një coban palestinez dhe një shofer taksie në Jeruzalemin lindor. Gjithashtu terrorist hebre ka deklaruar se ka vënë bomba në shtëpitë e izraelitëve dhe ka tentuar të vrasë edhe një profesor izraelit me

pikëpamje të majta. Pas arrestimit të tij, gazetë izraelite dolën me tituj të tillë si: "Kapet një terrorist cifut" Arrestimi i terroristit hebre tregon se terrorizmi nuk njihet as fe, as komb dhe duhet demaskuar e dënuar pa bërë diferencime dhe paragjykimë në mes të

tyre. Urojmë që Izraeli të vazhdojë të arrestojë dhe të denojë terroristë të tjerë izraelitë të cilët në Izraeli janë shumë dhe po kaq shumë ata janë të përfshirë në masakra nga më të përgjakshmet kundër popullsisë së pafajshme palestineze.

DENOHEN RREMBYESIT E IMAMIT TE MILANOS

Një gjykatë italiane ka dënuar 23 agjentë të CIA-s amerikane në mungesë të akuzuar për rrëmbimin e imamit të Milanos në vitin 1993. Ata u dënuan nga 5 deri në shtatë vjet burg. Ngjarja ka ndodhur pak vite më parë, kur, në kuadrin e operacioneve jashtë territorit të SHBA, agjentë të CIA-s, në bashkëpunim me agjentë të shërbimeve të fshehta italiane, arrestuan Abu Amar, imami i njohur i Milanos nën akuzën e shume perfolur për terrorizem, Ai, me një avion special, u transportua në Egjipt, ku iu dorëzua agjentëve të shërbimit të fshehtë egjiptian të cilët e torturuan muaj me rrallë në mënyrën me të

ashpër, por që u detyruan ta lirojnë për mungesë faktesh. Abu Omar, pasi u kthye në Milano, kishte deklaruar se ndjehej i dërmuar nga torturat dhe se atij i kishin mbetur tashti vetëm pak vite për të jetuar. Arrestimi i tij u bë lajm i parë mediatik, sepse ai ishte një figurë shumë e njohur fetare në Itali, i cili mbronte hapur vlerat e fesë islame në bisedat e tij fetare dhe demaskonte akuzat politike të pa baza që i bëheshin muslimanëve dhe fesë islame. Ndër të dënuarit nga gjykata italiane janë edhe shefat e CIA-s të Romës dhe të Milanos. Mediat theksojnë se të dënuarit nuk janë agjentë të thjeshtë, por oficerë të CIA-s, duke treguar se sa i rëndësishëm

ishte për shërbimet sekrete amerikane dhe egjiptiane arrestimi i imamit të Milanos. Mendohet se arrestimi i Abu Omarit ishte një mesazh për të gjithë ata që do ta ngrinin më shumë se duhet zërin për demaskimin e islamofobisë dhe gjithashtu ishte mesazh edhe për ata që do të ishin në vijën e parë të mbrojtjes së fesë islame nga sulmet e padrejta që i bëhen asaj në emër të një lufte imagjinare kundër terrorizmit. Urojmë që dënimi i 23 agjentëve të CIA-s të jetë një mesazh edhe për ata që mendojnë se me arrestime të padrejta dhe tortura do t'i largojnë muslimanët nga Islami, feja e tyre hyjnore. Por qeveria amerikane ka reaguar me ashpërsi ndaj ven-

dimit të gjykatës italiane duke deklaruar se ajo nuk do të ekstradojë 23 agjentët e CIA-s të akuzuar në Itali duke shtuar se do ta dërgojë vendimin e kësaj gjykate në një gjykatë të shakallës më të lartë. Gjithashtu, në reagimin e qeverisë amerikane thuhet se arrestimi Abu Omarit u bë për t'u marrë në pyetje në Egjipt dhe se pohimi i tij për tortura është vetëm një pretendim.

Ky ishte reagimi i qeverisë amerikane ndaj vendimit të një gjykate italiane që ëdenoi këto ditë 23 agjentë të CIA-s amerikane që arrestuan në Itali në vitin 2003 imaman musliman të Milanos Abu Omar.

OKB DENON KRIMET NE GAZA

Komisioni për të drejtat e njeriut pranë OKB, në një raport që ka bërë ditët e fundit, ka dënuar krimet që janë bërë në luftën e fundit që është zhvilluar në Gaza në mes të izraelitëve dhe Hamasit, duke i akuzuar të dy palët se kanë kryer veprime luftarake që janë shfaqje të krimeve kundër njerëzimit. Ushtria izraelite u akuzua se në sulmin që bëri në Ripin e Gazës, ka sulmuar edhe civilët që u bënë

shinjestra të ushtarëve izraelitë. Nga 1400 palestinezë të vrarë, gjysma e tyre ishin civilë të pafajshëm. Në një prononcim të fundit të kryeministrit izraelit, Natanjahu, ai e quajti raportin e OKB një raport që, sipas tij, e shtrembëron të vërtetën dhe se qeveria izraelite nuk do të pranojë dhe as nuk do të lejojë që ushtarët dhe ushtarakët e lartë të ushtrisë izraelite të gjykohen në Hagë për krime kundër njerëzimit. Natanjahu theksoi se

ushtria izraelite ka mbrojtur qytetarët dhe qytetet izraelite nga sulmi me raketa që i lëshonin palestinezët. Kurse Hamasi u akuzua, sepse ka goditur me raketa qendrat e banuara izraelite duke shkaktuar viktima në mes të civilëve. Kjo është pamja mediatike që u dha për teleshikuesit dhe ndëgjuesit e mediave të cilët nuk u informuan saktë për raportin e viktimave në mes të dy palëve të cilat, për hir të së vërtetës, as që mund

të krahasohen, sepse palestinezët e vrarë kapën shifrën 1400, kurse izraelitë të vrarë nuk kapën as shifrën 10, duke treguar se kjo ishte një luftë e pabarabartë, ku u vranë me qindra civilë palestinezë dhe se vrasësit e tyre nuk duhet të kenë imunitet për të vrarë dhe për të mos u gjykuar dhe dënuar për krime lufte.

MINISTRI I JASHTEM I TURQISE NE SHQIPERI

Ka arritur për një vizitë në Shqipëri ministri i jashtëm i Turqisë, Mehmet Davutullu, në ndër ministrat më të suksesshëm të qeverisë së kryeministrit aktual të Turqisë, Taip Rexhep Erdogan, i cili, për sukseset e tija në afirmimin e diplomacisë turke dhe në mbrojtjen me sukses të interesave të Turqisë në arenën ndërkombëtare, është quajtur nga analistët e huaj dhe diplomacia ndërkombëtare Kisingeri i Turqisë dhe njëkohësisht ai shquhet edhe si arkitekti i "Otomanisë së re", sepse këtij ministri i takon merita që diplomacia turke po afron dhe po rrit bashkëpunimin me shtetet turkofone dhe të tjera shtete që dikur ishin pjesë e Perëndorisë së lavdishme Osmane. Kjo vizitë e ministrit Davutullu bëhet në kuadrin e një sërë vizitash që po bën ai në vendet ballkanike të cilat filluan me vizitën në Bosnje që u pasua nga vizita në vendin tonë. Ministri i jashtëm turk u takua me kryeministrin Sali Berisha, me ministrin e

jashtëm Ilir Meta dhe me kryeparlamentaren Jozefina Topalli. Gjatë këtyre takimeve ministri Davutullu theksoi se mardhëniet në mes të Turqisë dhe të Shqipërisë janë të shkelqyera dhe se shkëmbimet tregtare në mes të dy vendeve po kapin shumën 1 miliard euro e cila në të ardhmen do të rritet edhe më shumë. Ne po nxisim biznesmenët në Turqi që të investojnë në Shqipëri, sepse jemi të interesuar që t'i cojmë më përpara mardhënjet në mes të dy vendeve-deklaroi ministri i jashtëm i Turqisë. Ministri i jashtëm turk theksoi rolin e madh të kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha, në fuqizimin e mardhënjeve në mes të Turqisë dhe të Shqipërisë. Turqia do të bëjë të pamundurën që Shqipëria të bëhet pjesë e gazsjellësit që do të kalojë afër hapësirës shqiptare dhe po te ishte vetëm në doren tonë, kjo do të bëhej që sot- theksoi me sinjeritet ministri Davutullu. Ai foli edhe për lidhjet e vjetra historike në mes të dy popujve të cilat datojnë shekuj më parë dhe që, për hir të vërtetës, ato janë mbajtur në këmbë dhe po

forcohen me një ritëm të pandërprerë. Sidomos, Davutullu theksoi angazhimin e madh të Turqisë për Kosovën, duke deklaruar publikisht se Kosova është problem me rëndësi tepër të madhe për diplomacinë turke. Turqia ishte shteti i parë në botë që e njohu Pavarësinë e Kosovës dhe është shteti që po bën përpjekje maksimale duke lobuar për të njohur sa më shumë shtete Pavarësinë e Kosovës- tha gjatë takimeve me politikanët shqiptarë ministri i jashtëm i Turqisë. Të mos harrojmë se mediat në Shqipëri vuajnë nga sindromi i turkofobisë dhe nuk e evidentuan asnjëherë njohjen e parë të Pavarësisë së Kosovës nga qeveria turke. Në ditën e dytë të qëndrimit të tij në Shqipëri, ministri Davutullu bëri një vizitë në Shkodër, ku u takua me Kryetarin e Bashkisë, Lorenc Luka, të cilit i kujtoi se, në Turqi, Shkodra është shumë e njohur për shkak se ne i kemi kulturat e përbashkëta. Duket se turqit kanë një respekt të vecantë për Shkodrën, sepse zyrtarë të lartë turq e kanë vizituar vazhdimisht qytetin më të madh

verior, kujtojmë vizitën e të ndjerit, Turgut Ozal, i cili zbriti nga makina dhe e përshkoi një pjesë të rrugës së hyrjes së qytetit të Shkodrës në këmbë, veprim që shfaqte dashurinë dhe respektin e tij personal dhe më gjërë për Shkodrën. Ministri i jashtëm turk informoi qeverinë shqiptare se mbrenda këtij viti Shqipërinë do ta vizitojë presidenti i Turqisë zotëria i tij i nderuar, Abdulla Gyl, vizitë kjo që tregon se Shqipëria është një ndër piketat më të rëndësishme të politikës dhe të strategjisë së Turqisë në Ballkan i cili është një hapësirë ku fjala e Turqisë thuhet është përcaktuese për problemet me të cilat përballen vendet e kësaj hapësirë të cilat ishin pjesë e Perëndorisë Osmane me të cilën keto vende bashkëjetuan shekuj të tërë.

Selim Gokaj

TURQIA PO MBULON HAPESIREN BALLKANIKE

Pas rolit tepër të rëndësishëm në Lindjen e Mesme dhe në Kaukaz, Turqia po mbulon edhe ngjarjet politike në Ballkan, i njohur si një hapësirë ku ajo ka investuar historikisht shekuj me rrallë, kur Perëndoria Osmane ishte prezente në Ballkan. Tashmë janë bërë dhe po bëhen publike vizitat e politi-

kanëve ballkanas në Turqi dhe ajo e politikanëve të Turqisë në vendet ballkanike. Sapo ka vizituar Sarajevën ministri i jashtëm turk, Davutullu, i cili u takua me presidentin bashnjak politikanin i njohur, Haris Silaxhixh, me të cilin edhe u falën në një nga xhamitë më të mëdha të Sarajevës. Pas daljes nga xhamia, ministri Davutullu dha një intervistë, ku theksoi rëndësi-

në e qetësisë në Bosnje. Ai deklaroi se qetësia në Bosnje është qetësi edhe për Turqinë, pohim ky që nuk kërkon shumë koment përse i takon rëndësisë që paraqet Bosnja për Turqinë. Një vizitë në Turqi bëri edhe presidenti i Maqedonisë, Ivanov i cili bisedoi në një takim me presidentin e Turqisë, Abdulla Gyl për mardhëniet dypalëshe dhe për mbështetjen që Turqia i ka

dhënë dhe po i jep Maqedonisë për problemet me të cilat ajo po ballafaqohet sot si mbrenda, ashtu edhe jashtë vendit. Presidenti Ivanov e falenderoi presidentin e Turqisë duke i thënë se Maqedonia i është shumë mirënjohëse Turqisë që e ka njohur atë më emrin e vërtetë të saj dhe se këtë veprim e bën vetëm një mik si është për Maqedoninë Turqia.

POLEMIKA KUNDER ORES ISLAME NE SHKOLLAT ITALIANE

Zvendës ministri për zhvillimin ekonomik në Itali, Urso, ka propozuar që në shkollat italiane publike dhe ato private të vendoset një orë mësimi për fenë islame. Ky propozim ka sjellë reagime nga nacionalistët dhe priftërinjtë që janë prononcuar kundër një nisme të tillë. Por, këtë nismë e ka përkrahur edhe politikani i njohur italian i majtë, D'Alema, i cili tha se kjo është një ide e drejtë. Fini një nga mbështetësit e kë-

tij propozimi thotë se nuk është një provokim, por ne duhet të fillojmë nga shkollat për të kultivuar një islam modern, larg radikalizimit. Kurse D'Alema theksoi se në një botë ideale duhet të kishte nga një orë mësimi për të gjitha fetë. Kardinali, Ersilio Tonini, tha se është një ide e papraktikueshme, sepse duhet kujdes maksimal në qëndrimin ndaj islamit. Kurse Luca Zaia, që përfaqëson Lega Nord, tha se ora e fesë katolike duhet të

jetë e detyrueshme për të gjithë studentët islamikë për të mësuar (sipas tij) kulturën tonë. Duhet theksuar se studentet emigrantë janë shtuar në Itali 10 vitet e fundit nga 25756 në vitin 1990 në 147406 në vitin 2000, me një rritje mesatare prej 28000 studenta në vit.

Shqetësimi i autoriteteve italiane për një orë mësimi të fesë islame nëpër shkollat është i lidhur me përcjelljen e masazhit islam mrenda atyre parametra-

ve që u interesojnë këtyre autoriteteve, duke angazhuar për këtë qëllim docentë italianë që kanë njohuri për fenë islame, ose imamë që janë të njohur dhe të përpunuar për të qëndruar në një linjë me këto autoritete, kur është fjala për të bërë një orë të fesë islame në shkollat private ose publike italiane.

Materjali është marrë nga gazeta

"Panorama" 18 tetor 2009

JETA E KESAJ BOTE ESHTË E SHKURTE DHE KALIMTARE

Në Kuranin e Madhërueshëm, Allahu xh.sh. e ka vënë në dukje shumë mirë rëndësinë e kësaj bote duke u dhënë fakte besimtarëve se jeta e kësaj bote është vetëm një përjetim mashtrues dhe se ajo është gjithashtu kalim i kohës në argëtim dhe në stoli. Ai thekson në suren En-Nexhm\29-30) "Andaj largohuni ndaj atij që i ka kthyer shpinën Kuranit të Madhërueshëm, i cili nuk do tjetër vecse jetën e dynjasë. Ajo është e tërë dituria që kanë arritur ata" Kurse në një hadith, Profeti a.s., thotë se dynjaja është burgu i besimtarit dhe xheneiti i jobesimtarit.. Vlen të theksohet se Profeti a.s. nuk pranoi celësat dhe depot e dynjasë që Allahu xh.sh. ia premtoi, duke urryer atë që Krijuesi e uren dhe nuk lartësoi atë që Krijuesi e poshtron. Allahu xh.sh. e shmangu dënjatë prej besimtarëve duke i zgjedhur ata në mes të të tjerëve dhe njëkohësisht ia zbukuroi dynjanë armiqve të Tij për t'i verbuar me bukurinë e kësaj dynjaje. Malik Ibn Dijnari, Allahu xh.sh. e mëshiroftë, ka thënë se duhet të ruhemi nga magjistarja dynja sepe ajo mund të magjepsë edhe zemrat e dijetarëve. Është provuar se jeta e kësaj dynja mund ta ketë fillimin e bukur, por fundin mund ta ketë shumë të rëndë. Dynjaja është një fushë, ku njeriut i duhet "të

luaj" me kujdes, sepse ajo ka rrugë shumë të ngatërruara dhe mund të sjellë edhe humbjen e besimtarit sepse ai mund të bëhet tifoz i saj, gjë që sjell largimin e besimtarit nga rruga e Krijuesit. Që besimtari ta shijojë këtë jetë, ai duhet të ecë në rrugën e Allahut xh.sh. e cila kërkon që besimtari ta adhurojë Atë dhe t'i bindet Atij. Besimtari e gjen bukurinë e Krijuesit tek besimi islam dhe tek imani i tij. Është pikërisht imani ai që besimtarit i jep mundësi që të fitojë mbi vështirësitë me të cilat ai ndeshet në këtë dynja. Është feja islame, që Krijuesi e zgjodhi për besimtarin musliman ajo që do t'i japë mundësi besimtarit musliman që një ditë të dalë para Krijuesit duke pohuar para tij: "O Zoti im! Unë të besova ty deri në vdekjen time" Në këtë dynja besimtari duhet të mos harrojë vdekjen dhe se ai duhet t'i frikësohet asaj, sepse ajo gjithmonë është shumë afër atij dhe është kurdoherë një caktim i Krijuesit. Në Kuranin e Madhërueshëm thuhet se ju keni afatin e një dite që ju nuk mund ta shtyni as nuk mund ta shpejtoni për asnjë moment. Njeriu në këtë dynja duhet të mos harrojë të mendojë për dhimbjet e vdekjes, për natën e varrit dhe për shtërngimin e tij, Ai nuk duhet të harrojë se jeta e kësaj dynjaje kalon shumë shpejt dhe meleku i vdekjes do të vijë, sapo të vijë dita e caktuar nga Krijuesi që ti të largohesh nga kjo

botë. Është detyrë e besimtarit që të pendohet për gjynahet që ai ka bërë në këtë botë dhe të pendohet për ata gjynahet. Ai duhet të mos harrojë se Krijuesi është falës shumë i madh për krijesën e tij më të përsosur që është njeriu. Prandaj, besimtari këtë dynja duhet ta konsiderojë edhe si një moment ku ai duhet të kërkojë falje para Krijuesit të tij për ata momente, kur ai ka qenë larg rrugës së Allahut xh.sh. Sidomos, besimtari nuk duhet të harrojë Ditën e Gjykimit, kur ai do të dalë para Krijuesit për të dhënë llogari për jetën që ka kaluar në këtë dynja. Dhe që të jëtë atë ditë pa gjynahet, besimtari duhet të kalojë këtë jetë në këtë dynja, vetën duke u mështetur në rrugën e Allahut xh.sh. dhe gjithmonë të kërkojë falje për gjynahet që besimtari ka bërë në këtë botë. Vetëm kështu ai do të dalë i fituar nga kurthet e shejtanit që e kërcënojnë pa ndërprerje besimtarin në këtë dynja. Dikush mund të thotë se kam bërë gjynahet të vogla. Por ai të mos harrojë se edhe gjynahi i vogël është një peshë që e rëndon besimtarin, pa harruar se duhet të ruhemi shumë edhe nga shirku, që është gjynahi më i madh, për të cilin nuk ka falje për atë që e bën. Vetëm imani dhe besimi i fortë mund ta shpëtojë besimtarin nga gjynahet e kësaj jete dynjaje. Besimtari duhet të jetë i kënaqur me atë që i ka caktuar Krijuesi në këtë dynja, sepse ve-

tëm kështu ai do të jëtë njeriu më i pasur dhe më i lumtur. Besimtari do të jetë i fituar në këtë dynja, kur ai do t'u qëndrojë sprovave që i con Allahu xh.sh. duke fituar mbi xhelozinë, koprracinë, mosbesimin, krenarinë dhe dukuri të tjera që të bëjnë të harrosh madhështinë e Krijuesit të Gjithësisë. Besimtari nuk duhet të harrojë se është në mes të xhenetit dhe të xhenemit dhe duhet të jetojë në këtë dynja që t'i shpëtojë zjarrit të xhenemit dhe të jëtë pjestar i xhenetit. Prandaj, që të gëzojë të mirat e pafundme të xhenetit, besimtari duhet të falenderojë Allahun xh. që e ka furnizuar në jetën e kësaj dynjaje, që e ka bërë trupin e tij në mënyrën më të përsosur që e ka mëshiruar dhe e ka falur për gjynahet që ka bërë kur ai është penduar për ato gjynahet. Prandaj, Allahu xh.sh. është i vetmi dhe i pa konkureshëm në adhurimin që duhet të bëjë një besimtar në këtë dynja. Besimtari nuk duhet të harrojë se jeta në këtë dynja është kalimtare për atë dhe se i fituar ai do të jetë në këtë dynja vetëm duke adhuruar Allahun xh.sh. dhe duke ecur vetëm në rrugën e tij. Është ky adhurim që besimtarin do ta shpëtojë nga xhenemi dhe do ta bëjë banor të xhenetit.

Kujtim Cufaj

Imam në xhaminë Kullaj

HELM I RREZIKSHEM I NJE FONDAMENTALISTI

Një mik me tregonte para disa vitesh për një dialog që kishte patur me një zonjë të nderuar me të cilën dikur kishin punuar së bashku si arsimtarë dhe po së bashku kishin vuajtur duke vrapuar pas makinave për të shkuar në shkollë dhe pastaj për t'u kthyer në shtëpi. Miku im, një ish-ateist i thekur, pas viteve 90, kur u rihap feja, ishte fatlum sepse e shikoi dritën e fesë dhe u bë pjesë e besimit musliman. Si familje muslimane ata e rritën portretin e tyre fetar falë shamisë me të cilën u mbulua gruaja e tij. Ai e vazhdoi bisedën duke më treguar se kur, së bashku me gruan e tij të mbuluar, kishin takuar zonjën me të cilën ai kishte punuar, ajo ishte shokuar kur e kishte parë gruan e mikut tim të mbuluar me shami dhe pak e habitur dhe pak e revoltuar kishte ngritur zërin duke lëshuar pasthirmën: "Po më vjen keq! Po më vjen keq që qenke mbuluar, në një kohë që edhe gruan e mikut tim e njihte shumë mirë. Miku im i indinjuar nga ky qën-

drim i ashpër i ish-kolegës së tij i tha: "Pse po shqetësohesh kaq shumë. Gruaja ime është gjallë dhe nuk i ka dalë letra në shtyllë. Zoja e nderuar e pyeti gruan e mikut tim se sa para u japin në xhami ju që jeni mbshtjelle (jeni mbuluar). Pasi mori përgjigjen e merituar se as në xhami dhe as në kishë nuk ndahen para për besimtarët, ish-kolegia e mikut tim e "kafshoi gjuhën dhe nuk u ndie më. Dialogu me mikun tim m'u kujtua këto kur në gazetën "Agon" lexova një shkrim të Frok Cupit, i njohur si një analist që i ka bërë dhe i bën oponencë të qëllim të fesë islame. Në shkrimin "Altari mes dhive" ai e prezanton vehten si një variant më i helmuar se ish-kolegia e mikut tim që ishte tërbuar nga mbulesa e gruas së tij. Froku mundohet të na e mbushë mendjen se komunistet muslimane të lagjes së tij paskan vënë shaminë, pasi u rihap feja, të sigurt se do të paguhen në xhami (si pas mendjes së helmuar të këtij fundamentalist) për vënien e shamisë (për ta nxirë

ai e quan shaminë ferexhe). Frok Cupi dhe shumë si ky Frroku i Cupit të cilët, për fat te keq nuk janë të paktë në numur, e kanë të qartë se shamia nuk vendoset nga femrat muslimane në kokë për të marrë shpërblim materjal, por shamia vendoset në kokë nga një femër muslimane, sepse ky akt është urdhër fetar dhe se shpërblimin e vertetë për atë femër muslimane që vendos shaminë, ai jep Allahu xh.sh. Duke servirur në media mendime dhe fakte të pavërteta, Frroku dhe të tjerë si ky, vazhdojnë linjën për të njollosur parimet e ndritura të fesë islame, por gjithmonë pa arritur qëllimin e tyre. Duke i qëndruar në linjë hebreut të kristianizuar, Alfred Moisiu, Frrok Cupi në këtë shkrim u kujton lexuesve se pjesa më e madhe e vizitorëve, që shkojnë në kishën e Lacit, janë muslimanë të cilët pak t'i gërvishtësh u del origjina e tyre e krishterë. Vizitorët muslimanë, që shkojnë në kishën e Lacit, janë të sëmure hallexhi që kërkojnë shërim dhe janë të gat-

shëm të shkojnë edhe te statuja e Budës, mjafton të shërohen (sa shërohen është problem tjetër). Për këtë fundamentalist të mbushur me helm, toleranca fetare në Shqipëri egziston sepse, sipas tij, nuk ka muslimanë dhe kristianë të vërtetë (po të kishte sipas Frrokut Shqipëria do të kishte provuar luftërat fetare). Frroku harron se toleranca është dukuri themelore e fesë islame të cilën besimtarët muslimanë e reflektojnë atë ndaj religjoneve të tjera. Pse janë tolerantë muslimanët falen në mes të rrugës dhe durojnë një islamofobi mediatike dhe më gjërë. Prandaj, Frrok Cupi është më mirë që të bëhet pjesë e kësaj tolerance fetare, sesa një zë i helmatisur fundamentalist që përpiqet (aq sa ka në mundësi) për të penalizuar këtë harmoni ndër-fetare e cila ka qenë dhe është një vlerë e cmuar e popullit shqiptar.

Alban Kastrati